

**VENDIM**  
**Nr. 67, datë 27.1.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 199, DATË 11.1.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MASËN E FINANCIMIT, KRITERET DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT TË NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË TË RINJ”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 4 e 8, të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 199, datë 11.1.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Përfitues të këtij programi janë punëkërkues të rinj, të diplomuar me arsim të lartë në nivelin “Bachelor” apo “Master”, nën moshën 30 vjeç. Punëkërkuesit do të përfitojnë formim nëpërmjet punës dhe punësimit, sipas fushës së diplomimit. Zyra përkatëse e punësimit financon punëdhënësin:

a) në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj, për trajnimin nëpërmjet punës për çdo person, për një periudhë 3-mujore;

b) për çdo punëkërkues të papunë të përfshirë në program me një pagesë pjesëmarrjeje në kurs, në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, për të gjithë kohëzgjatjen e trajnimit. Zyra përkatëse e punësimit kryen edhe derdhjen e kontributit për sigurimin nga aksidentet në punë, në masën 0.3 për qind të pagës minimale, i cili derdhet në degën përkatëse;

c) me një financim mujor, në masën e sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore mbi pagën 25 000 (njëzet e pesë mijë lekë) për 9 muaj, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se 15 muaj. Ky financim bëhet nga zyra e punësimit në degën përkatëse të tatimeve sipas procedurave përkatëse. Në rast se punëdhënësi paguan më shumë se 25 000 (njëzet e pesë) mijë lekë në muaj, është i detyruar të mbulojë sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore përtej kësaj vlere;

ç) për çdo punëkërkues të papunë të përfshirë sipas këtij programi, me katër paga, në vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë, në muajin e tretë e të katërt dhe në muajin e tetë e të nëntë të kontratës. Ndërsa për muajt e tjerë financon punëdhënësi.”.

2. Në fund të pikës 1 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Punëdhënësit e rinj, persona juridikë apo fizikë, kanë të drejtë të kërkojnë të përfshijnë në program deri në 40% të numrit të punonjësve të punësuar.”.

3. Në shkronjën “d”, të pikës 4, fjalja “Bëjnë përjashtim nga ky rregull personat juridikë/fizikë, të cilët kanë detyrime ndaj organeve tatimore, por në momentin e aplikimit në këtë program.” zëvendësohet me “Për personat juridikë apo fizikë, të cilët kanë detyrime ndaj organeve tatimore, por vërtetojnë se në momentin e aplikimit në këtë program.”.

4. Në pikën 8 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “b”, fjalët “... numri i të punësuarve dhe i atyre, që kërkohen për t’u punësuar nga punëdhënësi, është jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) persona ...” zëvendësohen me “... aplikuesit janë persona fizikë ...”.

b) Në shkronjën “c”, fjalët “... numri i të punësuarve dhe i atyre, që kërkohen për t’u punësuar nga punëdhënësi, është më shumë se 50 (pesëdhjetë) persona ...” zëvendësohen me “... aplikuesit janë

persona juridikë ...”.

5. Në pikën 11, pas emërimit “Shërbimit Kombëtar të Punësimit” shtohen fjalët “... pas hedhjes në sistemin përkatës, ...”.

6. Në pikën 14, fjalët “... zyra përkatëse të punësimit ...” zëvendësohen me emërtimin “Shërbimit Kombëtar të Punësimit”.

7. Në pikën 18 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Punëdhënësit i vazhdojnë kompensimi për periudhën e mbetur.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**